FALJA E AKSHAMIT (Që dallon nga namazet tjera që kanë nga katër rekate).

Akshami ka tre rekate. Duke patur për qëllim faljen e tij i fal tre rekatet e para njëlloj si tre rekatet e drekës, ndërsa pas kësaj nuk çohesh për rekatin e katërt, por ulesh duke thënë ALL-LLAHU EKBER dhe e përfundon namazin duke i thënë lutjet: ET TEHIJATU, SALAVATET, LUTJEN dhe jep SELAMIN.

FALJA E SYNETEVE

Falja e suneteve dy rekatëshe bëhet si falja e sabahut, ndërsa falja e suneteve katër rekatëshe bëhet si falja e drekës, me atë që duhet patur për qëllim (nijet) faljen e tyre

Tabela e rekateve

Namazi përbëhet nga pjesët e quajtura rekate.
Tabela tregon rekatet në secilin namaz:

rekate / namazi	Sunnet	Farz	Sunnet	Vitri
Sabahu	2	2		
Dreka	4	4	2	
Ikindia	(4)	4		
Akshami		3	2	
Jacia	(4)	4	2	3

- Çdo namaz, qoftë farz ose sunet falet për hir të Zotit dhe askujt tjetër.
- Namazet farz janë obligim nga Zoti për çdo musliman të vetëdijshëm, dhe për mosfaljen e tyre pa shkak pason dënimi në këtë jetë dhe pas vdekjes.
- Namazet sunete është mirë që të falen, ngase ato i ka falur edhe Muhamedi a.s. gjithmonë, kur ka patur mundësi. Në tabelë janë cekur 12 rekatet sunet që Muhamedi a.s. zakonisht i ka falur dhe e ka lavdëruar faljen e tyre duke thënë: "Çdo musliman që vullnetarisht falë 12 rekate gjatë ditës për hir të Allahut pos farzeve, Allahu do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhenet.
- "Ndërsa në një rast ai ka thënë: "Katër rekate para dreke, dy pas dreke, dy pas akshamit, dy pas jacisë dhe dy para sabahut". Transmetohet se ai ka falur namaz edhe pas ikindisë dhe para akshamit. Ai ka thënë: "Ndërmjet çdo ezani dhe ikameti ka namaz" dhe këtë e ka përsëritur 3 herë, pastaj ka thënë: Për atë që dëshiron."
- Namazi i vitrit nuk është mirë të lihet pa falur, edhe pse nuk është farz. Muhamedi a.s. atë nuk e ka lënë pa falur.
- Përveç këtyre namazeve, Muhamedi a.s. ka falur edhe namaze të tjera vullnetare, si p.sh. është ngritur natën dhe ka falur namaz nate, ose ka falur namaz pas lindjes së diellit, ose kur është zënë dielli, ndërsa ndonjëherë ka falur namaz para se të ndërmarrë ndonjë vendim të rëndësishëm për ndonjë çështje të kësaj bote. Këto janë namaze vullnetare dhe kryerja e tyre edhe pse nuk është e domosdoshme, çmohet shumë.

Pasqyra e lutjeve që thuhen gjatë faljes së farzeve

REKATET	KOHËT E NAMAZEVE				
	Sabahu	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia
1	Subhaneke Eudhubilahi **Fatiha** (Keuther)	Subhaneke Eudhubilahi **Fatiha** (Keuther)	Subhaneke Eudhubilahi **Fatiha** (Keuther)	Subhaneke Eudhubilahi **Fatiha** (Keuther)	Subhaneke Eudhubilahi **Fatiha** (Keuther)
2	**Fatiha** (Ihlas) Et-Tehijatu SELAMI	**Fatiha** (Ihlas) Et-Tehijatu	**Fatiha** (Ihlas) Et-Tehijatu	**Fatiha** (Ihlas) Et-Tehijatu	**Fatiha** (Ihlas) Et-Tehijatu
3		**Fatiha**	**Fatiha**	**Fatiha** Et-Tehijatu SELAMI	**Fatiha**
4		**Fatiha** Et-Tehijatu SELAMI	**Fatiha** Et-Tehijatu SELAMI		**Fatiha** Et-Tehijatu SELAMI

Ezani dhe Ikameti

Ezani thuhet para fillimit të namazit, ndërsa ikameti para fillimit të farzeve

Ezani	Ikameti		Përkthimi
4	4	All-llahu ekber	Allahu është më i Madhi
2	2	Esh-hedu en la ilahe il-lAll-llah	Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos Allahut
2	2	Esh-hedu enne Muhammederr-rresulull-Llah	Dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i Allahut
2	2	Hajje 'ales-salah	Eja në falje
2	2	Hajje 'alel-felah	Eja në shpëtim
2	-	Es-salatu hajrun minen-nevm (vetëm në sabah)	Falja është më e mirë se gjumi
-	2	Kad kametis-salah	Falja filloi
2	2	All-llahu ekber	Allahu është më i Madhi
1	1	La ilahe il-lAll-llah	S'ka hyjni tjetër pos Allahut

BOTUES

Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion - Lozanë

Falënderimi i takon Allahut, paqja qoftë mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi të gjithë besimtarët!

Association Cicra, Chemin du Couchant 4, 1022 Chavannes-près-Renens.
www.cicra.ch, info@cicra.ch, mob. 076 6151800, 078 7478425

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Udhërrëfyes i namazit

për fillestarë

suret dhe lutjet me përkthim

Krijuesiynë, Allahu, thotë:

14. Ka shpëtuar ai që është pastruar,
15. Që ka përmendur emrin e Zotit të vet dhe që është falur,
16. Por ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote,
17. Ndërsa jeta tjetër është më e mirë dhe e përherëshme! (Kuran: A'la, 17-17)

1. Kanë shpëtuar besimtarët,
2. Të cilët gjatë namazit janë të përulur...
9. Dhe të cilët e ruajnë namazin e tyre
10. Të tillët janë trashigimtarët
11. Trashiguesit e Firdeusit, ku do të banojnë përgjithmonë. (Kuran: El Mu'minun, 1-11)

Muhamedi a.s. ka thënë:

"Gjëja e parë për të cilën do të japë llogari robi (i Allahut) në Ditën e Ringjalljes është namazi. Nëse i ka kryer namazet sipas rregullave, atëherë do të jetë i shpëtuar dhe ka korrur sukses. Nëse do t'i mungojnë namazet (nuk është falë), do të përjashtohet nga mirësia dhe do të jetë i humbur. Nëse do të ketë diçka të paplotësuar nga farzet (obligimet e domosdoshme), Allahu i Lartmadhëruar do t'u thotë (melekëve): Shihni se a ka robi Im ndonjë namaz vullnetar, me të cilin do t'ia kisha plotësuar farzin. Pastaj edhe veprat tjera do të gjykohen në të njëjtën mënyrë."

Gjithashtu ka thënë:
"...Shtylla e fesë është namazi..."

Dhe:
"...Islam është:
1. Të dëshmosh se s'ka hyjni tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij;
2. Ta kryesh faljen e namazit;
3. Ta japish zekatin;
4. Ta agjërosh muajin Ramazan dhe
5. Ta kryesh haxhin, nëse ke mundësi."

Kushtet për vlefshmërinë e namazit:

- Nuk bën të jesh xhunub - i (e) papastruar nga kontakti seksual ose e papastruar nga cikli mujor (vlen për femrat).
Që të pastrohesh nga këto, duhet larë tërë trupi.

- Nuk bën ta kesh kryer nevojën (qoftë të madhen ose të voglën) dhe të mos e kesh larë vendin me ujë. Nëse je stërpikur (ndotur) me nevojë, duhet ta lash teshën ose ta ndërrosh atë.

- Namazi nuk vlen pa marrë abdest. Abdesti mirret kështu: Duke patur për qëllim marrjen e abdestit, thua "Bismilah", dhe I lan nga tre herë: duart, gojën, hundën, fytyrën, krahët deri mbi bërryl, I fërkon me dorë të lagët flokët dhe veshët, dhe I lan këmbët deri mbi nyje.

- Me një abdest mund të falen disa namaze, ndërsa abdestin e prishin kryerja e nevojës, lëshuarja e gazërave, gjumi, etj.

- Gjatë faljes, mashkulli duhet ta ketë të mbuluar trupin së paku prej kërthizës deri te gjunjët, ndërsa femra duhet ta mbulojë tërë trupin, pos fytyrës, duarve dhe këmbëve deri në nyje.

- Para se ta fillosh faljen, kthehesh drejt Qabesë dhe vendosesh para ndonjë sutre (sutre mund të jetë muri, druri, shpina e njeriut, guri pak më i madh ose ndonjë objekt tjetër jo i gjallë).

- Gjatë faljes ndalohet të folurit, të qeshurit, të shikuarit lartë ose anash dhe e gjithë kjo ka për qëllim koncentrimin sa më të madh të falësit, sepse ai vendos kontakt me Krijuesin e tij, i Cili meriton lavd-falënderim dhe frikërespekt të denjë.

- Para se të fillosh faljen, duhet ta kesh për qëllim faljen e kohës së caktuar. Nëse ndodh që ta falësh ikindinë, ndërsa për qëllim ke patur faljen e drekës, duhet ta përsërisësh namazin.

- Namazin e falë në kohën e përkatës.

Kohët e faljes

1. **Sabahu** fexhr	falet në agim, prej kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit, dhe vazhdon deri para lindjes së diellit.
2. **Dreka** dhuhr	falet pasi dielli të lëviz prej zenitit, deri në atë pozitë kur hija e objektit fiton gjatësinë e vet objektit.
3. **Ikindia** asr	falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri para perëndimit të diellit.
4. **Akshami** magrib	fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit.
5. **Jacia** isha'	falet pasi që horizonti errësohet plotësisht, deri para agimit.

Si merret abdesti?

Para se të merret Abdest, njeti për të marrë abdes duhet të bëhet në zemër, pastaj thuhet: Bismilah

1. Duart lahen deri në nyje. Lahen mirë pjesët mes gishtërinjve dhe tregohet kujdes të mos mbetet asnjë pjesë pa lagur.
2. Me dorën e djathtë fusim ujin në gojë. Çdo herë e nxjerrim ujin pasi e shpërlajmë mirë gojën. (3 herë).
3. Me dorën e djathtë marrim ujin, e tërheqim pak me hundë. Me dorën e majtë pastrojmë hundën. (3 herë).
4. Bashkojmë shuplakat e duarve, i mbushim me ujë dhe lajmë fytyrën. Fytyra lahet prej ku dalin flokët e deri nën mjekër dhe prej veshit në vesh. (3 herë).
5. Lajmë dorën e djathtë e pastaj të majtën deri mbi bërryla. (3 herë).
6. Me dorën e lagur fërkojmë pjesën e sipërme të kokës (1 herë).
7. Me duart të lagura fërkojmë veshët, gishtin tregues e vëmë në vesh, gishtin e madh pas veshit.
8. Në fillim lajmë këmbën e djathtë deri mbi nyje. Pastaj të majtën. Duhet të tregohet kujdes në larjen e pjesës mes gishtërinjve.

Pas abdesit themi shehadetin: ESH HEDU EN LA ILAHE ILA ALLAH VE ESH HEDU ENE MUHAMEDEN ABDUHU VE RESULUHU

Vazhdon

FALJA E SABAHUT (Shembulli i dy rekateve të cilat janë të ngjashme në të gjitha namazet tjera).

REKATI I PARË

1 I ngre duart te veshët, dhe thua:

	Përkthimet
All-llahu ekber	Allahu është më i Madhi

2 E vëndon dorën e djathtë mbi të majtën nën kërthizë, dhe thua:

Subhaneke All-llahumme we bi hamdike Ve tebarekesmuke ve te'ala xhedduke Ve la ilahe gajruke	Dëlirësia të takon Ty, Zoti im, dhe falënderimi, emri Yt është i bekuar, e lartësuar është Madhështia Yte, s'ka hyjni pos Teje
E udhu bil-Lahi minesh-shejtanir-raxhim	Mbështetem në Allahun nga djalli i mallkuar

FATIHA

1. Bismil-Lahirr-Rahmanirr-Rrahim
2. El hamdulil-Lahi rabbil 'alemin
3. Err-Rrahmanirr-Rrahim
4. Maliki jevmid-din
5. Ijjake na'budu ve ijjake neste'in
6. Ihdinas-siratal mustekim
7. Siratal-ledhine en 'amte 'alejhim, gajril magdubi 'alejhim ve led-dal-lin (amin!)

* Kjo është sureja (kaptina e Kur'anit) Fatiha, e cila duhet doemos të thuhet gjatë faljes së namazit

1. Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
2. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave
3. Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
4. Sunduesit të ditës së Gjykimit
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë
6. Udhëzona në rrugën e drejtë,
7. në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur! (Amin)

KEWTHER

1. Inna a'tajna kel kevther
2. Fe sal-li li rabbike venhar
3. Inne shanieke huvel ebter

* Kjo është sureja Kewther, në vend të së cilës mund të thuhet ndonjë sure tjetër e Kur'anit

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
1. Vërtet Ne të dhamë ty të Mirën (e pashtershme)
2. Pra falu për Zotin tënd dhe sakrifiko
3. Vërtet urrejtësi yt është farësosur.

3 Duke thënë: ALL-LLAHU EKBER kërrusesh dhe i I vë duart mbi gjunjë. Në këtë pozitë (e cila quhet ruku) thua tre herë:

Subhane rabbijel 'adhim	I Dëlirë është Zoti im Madhështor

4 Duke thënë:

Semi' All-llahu limen hamideh	Allahu dëgjon atë që e falënderon

drejtohesh dhe thua:

Rabbena lekel hamd	Zoti ynë, Ty të takon falënderimi

5 Thua ALL-LLAHU EKBER dhe përulesh me ballë në tokë. Në këtë pozitë (e cila quhet sexhde) thua tre herë:

Subhane rabbijel a'la	I Dëlirë është Zoti im i Lartë

6 Duke u ngritur nga sexhdeja thua: ALL-LLAHU EKBER, dhe ulesh. Në këtë pozitë thua:

Rabbigfirli, rabbigfirli	Zoti im, më fal! Zoti im, më fal!

7 Thua ALL-LLAHU EKBER dhe e bën edhe një sexhde duke thënë përsëri tre herë

Subhane rabbijel a'la	I Dëlirë është Zoti im i Lartë

8 Thua ALL-LLAHU EKBER dhe ngrihesh në këmbë për rekatin e dytë.

REKATI I DYTË

9 Përsëri e vëndon dorën e djathtë mbi të majtën dhe e thua suren FATIHA (shih veprimin 2), ndërsa pas saj suren IHLAS:

IHLASI

Bismil-Lahirr-Rahmanirr-Rrahim
1. Kul huvAll-llahu ehad
2. All-llahus-samed
3. Lem jelid ve lem juled
4. Ve lem jekul-lehu kufuven ehad

* Edhe në vend të kësaj sureje mund të zgjidhet ndonjë sure tjetër

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
1. Thuaj: Ai, Allahu është Një
2. Allahu është Strehuesi
3. S'ka lindur kë, as nuk është i lindur
4. Dhe Atij askush nuk i përngjan

10 Pas kësaj, si në rekatin e parë kërrusesh, drejtohesh dhe i bën dy sexhde (d.m.th. i përsërit veprimet 3,4,5,6 dhe 7). Pas sexhdes së dytë thua ALL-LLAHU EKBER, ulesh dhe thua:

TEHIJATI

Et-tehijjatu lil-lahi ves-salavatu vet-tajjibatu Es-selamu 'alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetull-llahi ve berekatuhu Es-selamu 'alejna ve 'ala 'ibadil-Lahis-salihin Esh hedu en la ilahe il-lall-llah Ve esh-hedu enne Muhammeden 'abduhu ve resuluhu	Përshëndetjet i takojnë Allahut, si dhe lutjet dhe fjalët e miraPaqja qoftë mbi ty, o Lajmëtar, si dhe mëshira e Allahut dhe begatitë e Tij Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Alllahut. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij.

11 PËRFUNDIMI I NAMAZIT: duke qenë ulur thua:

SALAVAT

All-llahumme sal-li 'ala Muhammedin ve 'ala ali Muhammed kema sal-lejte 'ala Ibrahime ve 'ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid	O Allahu im, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.
All-llahumme barik 'ala Muhammedin ve 'ala ali Muhammed kema barekte 'ala Ibrahime ve 'ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid	O Allahu im, begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.

LUTJA

All-llahumme rabbena atina fid-dunja haseneten ve fil-ahireti haseneten ve kina 'adhaben-nar. rabbena gfirli ve li validejje ve lil-mu'minine jevme jekumul hisab	O Allahu im, Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi me zjarr! Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët Ditën kur do ta japim llogari!

* Në vend të kësaj lutje mund të thuhet ndonjë lutje tjetër e transmetuar nga Pejgamberi a.s.

12 Namazi përfundon me dhënien e SELAMIT: e kthen kokën së pari në të djathtë dhe thua:

Es-selamu 'alejkum ve rahmetull-llah	Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju!

dhe në të majtë:

Es-selamu 'alejkum ve rahmetull-llah	Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju!

FALJA E DREKËS, IKINDISË dhe JACISË (Shembulli i dy rekateve të fundit).

Këto namaze kanë nga katër rekate. Duke patur për qëllim (nijet) faljen e namazit përkatës, i fal dy rekatet e para njësoj si në namazin e sabahut, deri në veprimin 10, ndërsa pas lutjes ET TEHIJATU duke thënë ALL-LLAHU EKBER ngrihesh në këmbë për rekatin e tretë.

REKATI I TRETË

13 I lidh duart dhe e thua vetëm suren FATIHA. Pastaj e kryen rukun, drejtohesh, i bën dy sexhde dhe duke thënë ALL-LLAHU EKBER ngrihesh në këmbë (si në veprimet 3,4,5,6 dhe 7).

REKATI I KATËRT

14 Edhe në këtë rekat e thua vetëm suren FATIHA, e kryen rukun, drejtohesh, i bën dy sexhde (veprimet 3,4,5,6 dhe 7) dhe në fund ulesh dhe e përfundon namazin me lutjet: ET TEHIJATU, SALAVAT dhe LUTJEN e fundit dhe në fund jep SELAMIN (veprimi 8).